



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 447/5 prot.,

Datë 20.02.2026

V E N D I M
Nr. 288/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitura nga operatori ekonomik “2AK Group” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me REF--73591-12-31-2025, me objekt: “Blerje materiale për zyra për nevojë të shoqërisë UKT sh.a.”, me fond limit 3.397.000 (tre milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

Lënien të skualifikimuar dhe shtim të arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë “KEJ Group” SHPK, Eduart Xhixha dhe “IGLI SAND” SHPK dhe nga procedura e mësipërme

Ankimues: Operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK me Nipt M113130290 dhe adresë: Rr. “Ndre Mjeda”, Kompleksi rezidencial “Magnet” Pallati Lura, njësi shërbimi nr.1017, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a
Rruga “Rruga e Kavajës”, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “2AK Group” SHPK me Nipt. M42626404R dhe adresë: Rruga “Kastriot Muco”,Lagja “8 shkurti”, Nd 66, Fier.

Operatori ekonomik “KEJ Group” SHPK me Nipt. M41707006H dhe adresë: Rruga “Sami Frasheri”, Pallatet “Agimi”, Shkalla 22, Ap. 370, Tiranë

Operatori ekonomik Eduart Xhixha me Nipt. L54424205B dhe adresë: Ndertese private, 2 kateshe,kati pare mbi toke, zona kadastrale nr.3096, me numer pasurie 97/32/1 Nikel, QEREKE Durrës

Operatori ekonomik “IGLI-SAND” SHPK me Nipt. J94625209A dhe adresë:,Rruga Kryesore, ndertese private 1 kateshe,zona kadastrale 3096, me nr.pasurie 88/32, Fshati Qereke, Nikel, QEREKE, Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimesi “Bajro Bros” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.01.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me REF--73591-12-31-2025, me objekt: “Blerje materiale për zyra për nevojat të shoqërisë UKT sh.a.”, me fond limit 3.397.000 (tre milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2. Në datën 16.01.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 30.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. ERZENI/SH sh.p.k	2.093.600 lekë	s’kualifikuar
2. SHAGA. Sh.p.k	2.249.850 lekë	s’kualifikuar
3. KEJ Group sh.p.k	2.383.000 lekë	s’kualifikuar
4. 2AK Group sh.p.k	2.532.000 lekë	kualifikuar
5. Eduard Xhixha Pf	2.587.000 lekë	s’kualifikuar
6. IGLI-SAND sh.p.k	2.627.500 lekë	s’kualifikuar
7. Bajro Bros sh.p.k.	2.686.700 lekë	kualifikuar
8. Erblina Beqiri P.f	2.698.500 lekë	s’kualifikuar
9. Telia Kurti P.f	2.790.000 lekë	s’kualifikuar
10. BENNETT sh.p.k	2.842.500 lekë	kualifikuar
11. TETEA sh.p.k.	2.990.000 lekë	kualifikuar
12. BOLT sh.p.k.	3.180.000 lekë	kualifikuar
13. ERALD sh.p.k.	3.183.850 lekë	kualifikuar
14. ISEC sh.p.k.	3.243.940 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 06.02.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6317 datë 11.02.2026 dhe me Nr. 447/2026 Prot., datë 12.02.2026 e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitura nga operatori ekonomik “2AK Group” SHPK dhe lënien të skualifikikuar dhe shtim të arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë “KEJ Group” SHPK, Eduart Xhixha dhe “IGLI SAND” SHPK dhe nga procedura e mësipërme me pretendimin si më poshtë:

1- “.....OE - 2AK Group, nuk ka plotësuar sakte Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, konkretisht për pjesën II “Shkaqet e përjashtimit” në pikën A: “ Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” ka dhënë informacion dhe dokumentacionin apo institucionin ku mund të kryhet verifikimi i këtij informacioni për disa prej rubrikave që lidhen me plotësimin e kërkesave të përgjithshme të kualifikimit, por nuk ka dhene asnje informacion per dy rubrikat e poshteshenuara: 1- operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të

vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.....2- operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet

që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.....

2- OE - 2AK Group, nuk ploteson piken 2.3.1. a dhe 2.3.1.b te kapacitetit teknik te kerkesave per kualifikim:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit . Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne orgamet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Nisur nga ekstrakti i QKB -se se ketij OE, del qarte qe ky OE, nuk ka si objekt te veprimtarise se tij shitjen e mallrave objekt prokurimi – RAFTE METALIKE (afro 40% e preventivit) dhe MOBILJE ZYRASH (afro 60% e preventivit), ne keto kushte, Faturat e paraqitura si furnizime te ngjashme, nga ana e ketij OE te realizuara me sektorin publik, nuk jane te shoqeruara me vertetime te realizimit te kontratave perkatese (sic cilesohet ne kerkesen e mesiperme per kualifikim), ndersa Faturat e paraqitura si furnizime te ngjashme, me sektorin privat nuk jane te ngjashme me objekin e prokurimit dhe nuk plotesojne 20 perqind te fondit limit te kerkuar ne DT.

3- OE - 2AK Group, nuk ploteson piken 2.5 te kapacitetit teknik te kerkesave per kualifikim:

2.5. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese në sistemin elektronik katalogun/et/ të prodhuesit/ve te mallrave objekt prokurimi. Në rast se katalogjet janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe sipas legjislacionit në fuqi

- Duke qene se nga ekstrakti i ketij subjekti del se OE 2AK Group nuk eshte prodhues i mallrave objekt prokurimi, ky OE nuk ka deklaruar se kush jane prodhuesit e mallrave objekt prokurimi si dhe kryesorja,

- Katalogu i paraqitur nga ana e ketij OE nuk eshte nen LOGON/autoritetin e prodhuesve te mallrave – Metalike dhe mobilje (sic kerkohet ne kerkesen e mesiperme).

- Ne katalogun e paraqitur nuk paraqiten te gjitha specifikimet teknike te te gjitha mallrave objekt prokurimi, katalog i cili nuk ploteson kerkesen e AK.

4- OE – 2AK Group,

- nuk ka plotesuar paragrafin 5 te pikes 6 te nenit 26 - Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, te VKM- se nr 285/2021, i ndryshuar, ne te cilin thuhet:

“Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin.

Gjithashtu, DOKUMENTET PROVUESE, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin DHE TË PROVOJNË GJENDJEN FAKTIKE TË OFERTUESIT NË KOHËN E OFERTIMIT TË TIJ

OE – 2AK Group, ne momentin e kerkuar, ka paraqitur dokumenta te cilat NUK PROVOJNË GJENDJEN FAKTIKE TË OFERTUESIT NË KOHËN E OFERTIMIT TË TIJ.

Dokumentat e paraqitura nga ana e ketij OE, si psh: VERTETIMIN PER PAGESEN E TAKSAVE DHE TATIMEVE, VERTETIMIN PER PAGESEN E SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE, vertetim per pagesen e energjise elektrike, Vertetim per pronaret

perfitues, VERTETIM PER GJENDJEN GJYQESORE PER SUBJEKTIN ADMINISTRATORIN DHE ORTAKET, Vertetim nga gjykata per subjektin, administratorin dhe ortakët, Vertetim nga prokuroria per subjektin, administratorin dhe ortakët, etj, JANE DOKUMENTA TE DATAVE PAS DATES SE OFERTIMIT, pra ne kundershtim me kerkesen e mesiperme te VKM- se dhe DT.

- NUK KA PARAQITUR, ose e ka paraqitur kopje te pa njehesuar me origjinalin, DOKUMENTACIONIN per punonjesit e deklaruar per punonjesit e deklaruar tek formulari i vetedeklarimit, Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit në pikën B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, paragrafi 1. si psh kontratat e punes etj ne te cilat tregohet profili i punonjesve te deklaruar, Si dhe

- NUK KA PARAQITUR, ose e ka paraqitur kopje te pa njehesuar me origjinalin, DOKUMENTACIONIN PER MJETET DHE MAKINERITE e deklaruar tek formulari i vetedeklarimit, Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit në pikën B:DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, paragrafi2.

Sa me siper me faktet dhe argumentat e paraqitura nga ana jone, KERKOJME REFUZIMIN E OFERTES SE OE – 2AK Group, ne kete procedure prokurimi.

B- Kerkojme:

1- Mbjajtjen te skualifikuar me arsyet e gjetura nga KVO- ja, te OE - KEJ Group.

2- Shtimin e arsyeve te skualifikimit te OE - KEJ Group, si me poshte:

- OE - KEJ Group, nuk ka plotesuar sakte Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, konkretisht për pjesën II “Shkaqet e përjashtimit” në pikën A: “ Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” ka dhënë informacion dhe dokumentacionin apo institucionin ku mund të kryhet verifikimi i këtij informacioni për disa prej rubrikave që lidhen me plotësimin e kërkesave të përgjithshme të kualifikimit, por nuk ka dhene asnje informacion per dy rubrikat e poshteshenuara: 1- operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj

kontrate.....2- operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar nuk zbaton detyrimet

që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Kategoritë e profesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për punën.....

- OE - KEJ Group, nuk ploteson piken 2.3.1. a dhe 2.3.1.b te kapacitetit teknik te kërkesave per kualifikim:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit . Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës,

ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat e paraqitura si furnizime të ngjashme, nga ana e këtij OE të realizuara me sektorin publik, nuk janë të shoqeruara me vertetime të realizimit të kontratave perkatese, ndërsa Faturat e paraqitura si furnizime të ngjashme, me sektorin privat nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit dhe nuk plotësojnë 20 përqind të fondit limit të kërkuar në DT.

- OE - KEJ Group, nuk plotëson pikën 2.5 të kapacitetit teknik të kërkesave për kualifikim:

2.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në sistemin elektronik katalogun/et/ të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi. Në rast se katalogjet janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe sipas legjislacionit në fuqi

- Duke qenë se nga ekstrakti i këtij subjekti del se OE KEJ Group nuk është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ky OE nuk ka deklaruar se kush janë prodhuesit e mallrave objekt prokurimi si dhe kryesorja,

- Katalogu i paraqitur nga ana e këtij OE nuk është nën LOGON/autoritetin e prodhuesve të mallrave – Metalike dhe mobilje (sic kerkohet në kërkesën e mesipërme).

- Në katalogun e paraqitur nuk paraqiten të gjithë specifikimet teknike për të gjithë mallrat objekt prokurimi, katalog i cili nuk plotëson kërkesën e AK.

Prandaj kërkojmë që OE - KEJ Group, duhet të mbetet i skualifikuar duke i shtuar edhe arsyet e mesipër argumentuara nga ne.

C- Kërkojmë:

1- Mbatjen të skualifikuar me arsyet e gjetura nga KVO-ja, të OE – Eduart Xhixha.

2- Shtimin e arsyeve të skualifikimit të OE - Eduart Xhixha, si më poshtë:

- OE - Eduart Xhixha, nuk plotëson pikën 2.5 të kapacitetit teknik të kërkesave për kualifikim:

2.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në sistemin elektronik katalogun/et/ të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi. Në rast se katalogjet janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe sipas legjislacionit në fuqi

- Duke qenë se nga ekstrakti i këtij subjekti del se OE Eduart Xhixha nuk është prodhues i të gjithë mallrave objekt prokurimi (konkretisht të raftëve metalike), ky OE nuk ka deklaruar se kush është prodhuesi i mallrave objekt prokurimi - raftëve metalike, si dhe kryesorja,

- Katalogu i paraqitur nga ana e këtij OE nuk është nën LOGON/autoritetin e prodhuesve të mallrave – Metalike dhe mobilje (sic kerkohet në kërkesën e mesipërme).

- Në katalogun e paraqitur nuk paraqiten të gjithë specifikimet teknike për të gjithë mallrat objekt prokurimi, katalog i cili nuk plotëson kërkesën e AK.

Rrjedhimisht, kërkojme që OE - Eduart Xhixha, duhet të mbetet i skualifikuar duke i shtuar edhe arsyet e mesiper argumentuara nga ne.

D- Kërkojme:

1- Mbajtjen të skualifikuar me arsyet e gjetura nga KVO- ja, të OE – “IGLI SAND”.

2- Shtimin e arsyeve të skualifikimit të OE “IGLI SAND”, si më poshte:

- OE - “IGLI SAND”, nuk plotëson piken 2.5 të kapacitetit teknik të kërkesave për kualifikim:

2.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në sistemin elektronik katalogun/et/ të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi. Në rast se katalogjet janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe sipas legjislacionit në fuqi

- Duke qenë se nga ekstrakti i këtij subjekti del se OE “IGLI SAND” nuk është prodhues i të gjithë mallrave objekt prokurimi (sidomos të raftëve metalike), ky OE nuk ka deklaruar se kush është prodhuesi i mallrave objekt prokurimi - raftëve metalike, si dhe kryesorja,

- Katalogu i paraqitur nga ana e këtij OE nuk është nën LOGON/autoritetin e prodhuesve të mallrave – Metalike dhe mobilje (sic kërkohej në kërkesën e mesiperme).

- Në katalogun e paraqitur nuk paraqiten të gjithë specifikimet teknike për të gjithë mallrat objekt prokurimi, katalog i cili nuk plotëson kërkesën e AK.

Rrjedhimisht, kërkojme që OE - “IGLI SAND”, të mbetet i skualifikuar duke i shtuar edhe arsyet e mesiper argumentuara nga ne.

Pra, prej operatorëve ekonomikë: 2AK Group, KEJ Group, Eduart Xhixha, “IGLI SAND”, ËSHTË PARAQITUR NJË FORMULAR PERMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT JO SIPAS SHTOJCËS 9, pjesë e dokumentave standarde të tenderit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP. Çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet si e pa vlefshme.

Referuar sa më sipër, operatori ekonomik: 2AK Group, KEJ Group, Eduart Xhixha, “IGLI SAND”, nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 9, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos pasur pjesë të këtij formulari dy rubrikat e cituara më sipër në këtë vendim, sic ky formular parashikon.

Në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

Kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më lart, operatori ekonomik : 2AK Group , KEJ Group, Eduart Xhixha, “IGLI SAND ka plotësuar vetëm disa prej rubrikave të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, ndërsa dy rubrikat e cituara më lart lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme për kualifikim nuk janë pjesë e formularit të vetëdeklarimit të paraqitur prej tij, duke mosplotësuar kështu pikën 2.a të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, për dorëzimin e Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9.

Sa me sipër me faktet dhe argumentat e paraqitura nga ana jone, KERKOJME:

A- SKUALIFIKIMIN E OFERTES SE OE – 2AK Group, ne kete procedure prokurimi.

B- Mbajtjen te skualifikuar me arsyet e gjetura nga KVO- ja, dhe Shtimin e arsyeve te skualifikimit te OE KEJ Group.

C- Mbajtjen te skualifikuar me arsyet e gjetura nga KVO- ja, dhe Shtimin e arsyeve te skualifikimit te OE Eduart Xhixha.

D- Mbajtjen te skualifikuar me arsyet e gjetura nga KVO- ja, dhe Shtimin e arsyeve te skualifikimit te OE “IGLI SAND”.....”

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 447/1 prot., datë 12.02.2026, me kriteret për të cilat operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “2AK Group” SHPK dhe shtim të arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë “KEJ Group” SHPK, Eduart Xhixha dhe “IGLI SAND” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 19426/13 prot., datë 17.02.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 447/2 prot., datë 19.02.2026, me objekt “Informacion mbi Kthim Përgjigjen ankesës për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale për zyra për nevojat e shoqërisë UKT sh.a”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranim të ankesës së operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk ka argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK se: OE “2AK Group” SHPK, nuk plotëson pikën 2.5 të kapacitetit teknik të kërkesave për kualifikim me argumentimin se nga ekstrakti i këtij subjekti del se OE 2AK Group nuk është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ky OE nuk ka deklaruar se kush janë prodhuesit e mallrave objekt prokurimi si dhe kryesorja, Katalogu i paraqitur nga ana e këtij OE nuk është nën LOGON/autoritetin e prodhuesve të mallrave – Metalike dhe mobilje (sic kërkohet në kërkesën e mësipërme). Në katalogun e paraqitur nuk paraqiten të gjithë specifikimet teknike të të gjithë mallrave objekt prokurimi, katalog i cili nuk plotëson kërkesën e AK....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. . Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.5, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“2.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në sistemin elektronik katalogun/et/ të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi. Në rast se katalogjet janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe sipas legjislacionit në fuqi. »

III.1.2. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike ” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar artikujt si më poshtë vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet Teknike

Rafte metalike

Materiali	Metal i galvanizuar ose i lyer me bojë antikorrozive
Lartësia	2.70 cm
Gjerësia	100 cm
Thellësia	40 cm
Kapaciteti mbajtës për raft	Min. 60 kg për raft
Montimi	I çmontueshëm, i përshtatshëm për transport dhe rivendosje
Stabiliteti	Me mbështetje anësore për siguri të lartë
Përdorimi	I përshtatshëm për dosje arkivore, kuti dokumentash dhe dosje me mekanizëm
Sasia	105 m/l

Dollapë zyre

Përmasat e dollapit	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia	Ndarëset
Dollap zyre	135 cm	50 cm	225 cm	40 cm
Dollap zyre	135 cm	50 cm	225 cm	40 cm
Dollap zyre	90 cm	50 cm	200 cm	40 cm

Specifikime Teknike:

Ngjyra e dollapeve të jetë e bardhë, dërrasë e grimcuar, një material druri, i përbërë nga copa të vogla druri, zakonisht pishe ose bredhi, të shtypura së bashku nën presion dhe nxehtësi të lartë duke përdorur rrëshirë. Rezistente ndaj deformimit, gërryerjes dhe stresi fizik. Mekanizëm mbylljeje me dryn duke siguruar sigurinë e artikujve ose dokumenteve.

Karrige zyre:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Karrige pune për zyrë	Copë	55
2	Karrige drejtuesi	Copë	4

Specifikime Teknike:

Baza e karriges te jete 5 yje prej poliamidi termoplastik me diametër jo me pak se 640 mm. Rrotat duhet të jenë binjake (dyshe) të bëra nga poliamidi, me një mbulesë mbrojtëse të bërë nga i njëjti material. Aktivizimi i ngritjes së gazit të rregullimit të lartësisë duhet të arrihet përmes një leve e cila te jete e aksesueshme anash nën ndenjësë. Mekanizmi mbështetës i ndenjësës duhet të jetë me mekanizëm "Synchro" dhe i bërë nga alumini dhe çeliku. Të lejojë shtrirjen e sinkronizuar të sediljes me 11° dhe të mbështetëses me 22° me mundësi stabilizimi në 5 pozicione. Mekanizmi me sistem "anti-panik" dhe një sistem rregullimi për shtrirje të balancuar sipas peshës së përdoruesit. Aktivizimi duhet të arrihet nëpërmjet të njëjtës levë që përdoret për rregullimin e lartësisë së sediljes. Rregullimi i forcës rivendosëse të shtrirjes te arrihet me anë të një rotorit të vendosur poshtë dhe brenda qendra e mekanizmit. Pllaka e ndenjësës të jetë prej poliamidi të derdhur me injeksion (PA6). Në pjatën e ndenjësës shtrihet jastëk i bërë nga shkumë poliuretani i zgjeruar me trashësi jo me pak se 50 mm, i cili te jete i veshur me susta me pëlthurën e zgjedhur. Dimensionet e ndenjësës: gjerësia jo me pak se 480 mm, thellësia jo me pak se 480 mm. Mbështetja e shpinës të përbëhet nga një kornizë anatomike e bërë nga kryq rrethor i formuar dhe i salduar seksioni $\Phi 16 \times 1,5$ mm profile çeliku, mbi të cilat te jete aplikuar një mbështetëse rrjetë, në mënyrë që siguron shpërndarje të barabartë të presionit. Mbështetësja rrjetë te jete montuar në Synchro mekanizëm me pllakë çeliku të formuar. Përmasat e mbështetëses 420 mm X 550 mm +/- 20mm. Mbështetësit e krahëve të ndenjësës te jene prej poliamidi të derdhur me injeksion dhe janë të fiksuara, të montuara në vend. Pjesa e sipërme e mbështetëses së krahut 200 mm X 70 mm +/- 10 mm. Gjerësia e mbështetëseve të krahëve te jete fikse, jo me pak se 470 mm.

Karrige drejtuesi për zyrë. Baza e karriges duhet të ketë një diametër prej jo me pak se 660 mm në formë 5 yje. Në mekanizmin e karriges duhet të jetë vendosur aktivizimi i ngritësit të gazit rregullues sipas lartësisë. Pistoni i gazit për rregullimin e lartësisë së sediljes aktivizohet nga një levë e vendosur nën dhe anash sediljes. • Mbështetësja e karriges duhet të jetë me mekanizëm Synchro, që lejon lëvizjen dinamike të njëkohshme të ndenjësës dhe mbështetëses, që të mund të rregullohet sipas peshës së përdoruesit duke u pozicionuar në të paktën 2 (dy) nivele. Korniza e Mbështetëses të jetë e përbërë nga profile poliamide termoplastik për shpërndarjen e presionit, që të sigurojë rehati dhe ergonomi maksimale. Mbulesa e pasme e mbështetëses, të jetë e përbërë nga një kornizë anatomike nga profilet e poliamidit, mbi të cilat të vendoset një mbështetëse rrjetë me përbërje lëkurë ekologjike, ose te jete komplet lekure ekologjike, e njejte me ndenjesen (sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor pas lidhjes se kontrates). • Ndenjësja e karriges të jetë e përbërë nga poliamid termoplastik dhe jastëku të jetë i mbushur me shkumë poliuretani, dhe mbulesa e jastëkut të jetë me lëkurë artificiale/prodhuar, dhe mekanizëm lëvizje për rregullim pozicioni (të rreshqasë horizontalisht në thellësi) në të paktën 2 nivele nëpërmjet një leve e vendosur nën/anash sediljes dhe e lehtë në përdorim. • Krahët e karrigeve të jenë të përbërë nga poliamidi termoplastik dhe i rregullueshëm në lartësi. Pjesa e sipërme e krahëve të mund të rrotullohet

(majtas-djathtas), të ketë përbërje poliuretani i hedhur me fortësi të mesme për rehati maksimale, ergonomi si edhe mundësi të zhvendoset para-mbrapa në të paktën 2 (dy) pozicione. • Koka e karriges të ketë mekanizëm të lëvizshëm dhe të lëvizë lart-poshtë, në të paktën 2 (dy) nivele dhe jastëku të jetë i mbushur me shkumë poliuretani, dhe mbulesa e jastëkut të jetë me lëkurë artificiale/prodhuar. • Karrigia të ketë kokën dhe ndenjësën me tapiceri të të njëjtës material, me lëkurë artificiale/prodhuar.

Komodinë:

Nr	Përshkrimi	Nësia	Sasia
1	Komodinë	Copë	7

Specifikime Teknike:

Komodinë me 3 sirtarë, të ofrojë hapsirë të bollshme magazinimi për të gjitha gjërat e nevojshme të zyrës, në ngjyrë gri. Të jetë rezistente ndaj presionit mekanik dhe temperaturave ekstreme. Materiale melamine. Permasat: gjerësia: 35 cm, thellësia: 40 cm, lartësia: 65 cm.

Grila për ambjent të brendshëm:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Grila të brendshme, material 100 % poliestër, kasë plastike, ngjyrë gri.	Copë	120 x 250 cm

III.1.3. Në shtojcën 7 “Formulari i Sasisë dhe Grafiku i Lëvrimit ” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar artikujt si më poshtë vijon:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrim:

1	2	3	4	5
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Njesia	Sasia	Afati i levrimit

1	Rafte metalike 100cm*40cm*270cm	ml	105	1 muaj nga nenshkrimi I kontrates
2	Dollapë zyre 135cm*55cm*225cm(h)	copë	2	1 muaj nga nenshkrimi I kontrates
3	Dollapë zyre 90cm*50cm*200cm(h)	copë	1	1 muaj nga nenshkrimi I kontrates
4	Karrige pune për zyrë	copë	55	1 muaj nga nenshkrimi I kontrates
5	Grila të brendshme, material 100 % poliestër, kasë plastike, ngjyrë gri. 120 x 250 cm	copë	1	1 muaj nga nenshkrimi I kontrates
6	Karrige drejtuesi	copë	4	1 muaj nga nenshkrimi I kontrates
7	Komodine Permasat: gjerësia: 35 cm, thellësia: 40 cm, lartësia: 65 cm	copë	7	1 muaj nga nenshkrimi I kontrates

III.1.4. Në përmbushje të kriterëve më sipër operatori ekonomik “2AK Group” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

_Katalog

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.6. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.7. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.8. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre

viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, 7 mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

9. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përllogaritur.

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në pikën 2.5 ka kërkuar shprehimisht që: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në sistemin elektronik katalogun/et/ të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi. Në rast se katalogjet janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe sipas legjislacionit në fuqi”. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “2AK Group” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.4. të këtij vendimi Katalog 2020 i kompanisë EMKO në të cilin paraqiten produkte të kësaj

kompanie dhe konkretisht Karrige; Amfiteatër, Auditorë, Salla Seminaresh, Klasa Shkolle(Universitete), Salla Mbledhjesh, laboratorë, Dollapë metalikë, Skafale metalik, Ambiente Pritjeje, miks, Kolltukë dhe Stadiume. .

Lidhur me pretendimin e ankuesit se “Ne katalogun e paraqitur nuk paraqiten te gjithë specifikimet teknike te te gjithë mallrave objekt prokurimi”, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor në shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka përcaktuar specifikimet teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi raftë metalike, dollapë, karrige pune për zyrë, grila të brendshme, karrige drejtuesi dhe komodinë. Operatori ekonomik “2AK Group” SHPK, për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.5” të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të këtyre dokumentave në dokumentin “Katalog” ka deklaruar produkte të kompanisë EMKO të cituara më sipër dhe ajo çfarë evidentohet është se në to nuk janë të përfshirë të gjithë artikujt objekt prokurimi dhe njëkohësisht për produktet karrige, dollape dhe kolltukë, ky dokument nuk ka asnjë të dhënë teknike të këtyre produkteve lidhur me parametrat teknikë të kërkuara në dokumentat e tenderit, përse i përket llojit të materialit, përmasave rezistencës së materialit, llojit të bazamentit etj. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “2AK Group” nuk e ka përmbushur kriterin kualifikues të sipërpërmendur përse i përket produkteve të ofruara, pasi me dokumentin “KATALLOG” nuk arrin të dëshmojë mbi të gjitha produktet e ofruara dhe njëkohësisht për disa nga këto produkte nuk plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave të tenderit sepse në këtë dokument nuk ka asnjë parametër teknik të deklaruar nga prodhuesi lidhur me llojin e materialit, përmasat, rezistencën e materialit, llojin e bazamentit të produktit të ofruar, dhe njëkohësisht nuk ka katalog për të gjithë artikujt e kërkuar në DST.

KPP sqaron, se subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik “2AK Group” SHPK duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Në këtë kuadër KPP gjykon, se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron, pasi katalogu/skeda teknike e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik nuk përmban të dhëna për të gjithë artikujt objekt prokurimi sic e përcakton dhe kriteri 2.5 të DST. Sa më lart, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues nuk do të konsiderohet i rregullt, duke mosplotësuar kështu kriterin kualifikues të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.5 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “2AK Group” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërme i ankimuesit qëndron dhe gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “2AK Group” SHPK pas arsyetimit të KPP do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese, nuk ndryshojnë gjendjen juridike të operatorit ekonomik “2AK Group” SHPK, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK përse i perket operatorëve ekonomikë “KEJ Group” SHPK, Eduart Xhixha dhe “IGLI SAND” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre operatorëve ekonomik është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 30.01.2026, ku këta operatorë ekonomikë rezultojnë të skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që këta operatorë ekonomikë të jenë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK për operatorët ekonomikë “KEJ Group” SHPK, Eduart Xhixha dhe “IGLI SAND” SHPK nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me REF--73591-12-31-2025, me objekt: “Blerje materiale për zyra për nevojë të shoqërisë UKT sh.a.”, me fond limit 3.397.000 (tre milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

2. Autoriteti Kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “2AK Group” SHPK sipas konstatimeve të këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publikk.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

